

Ilir. Rexhepaj
Dr. Financave
Dr. Taksohe



25
07.01.22

07.01.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 1/ prot.

Kukës më, 06.01.2022

L E N D A :

Verifikimi i Ligjshmërisë së Aktit.

KRYETARIT TË BASHKISË

KËSHILLIT BASHKIAK

KUKËS

Bazuar në nenin 16, pika 2, shkronja “ b “ të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi verifikova kompetencën, juridiksionin dhe bazën ligjore të vendimit të datës 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak Kukës

V E N D O S A :

Të Konfirmoj vendimin Nr.71 të datës 24.12.2021, të Këshillit Bashkiak Kukës

Vendim 71; Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54/dh, 55/3, ligjin nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 6,10,22,28,40,41, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenet 6,15,44, ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,(indryshuar), ligjin nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 “Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,(indryshuar) pikat 94,96,100,113,120,122, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Udhëzimin nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024 ”Udhëzimin Plotësues Nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, Shkresës Nr.18976 prot datë 29.10.2021 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2022”, **mori vendim:**

.Të miratojë Buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2022, si më poshtë:

- Parashikimin e të ardhurave për vitin 2022, në vlerën totale **1,409,268**(njëmiljon e katërqind e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) në **mijë lekë**, sipas tabelës Nr.1, bashkëngjitur këtij vendimi.

- b) Shpërndarjen e burimeve financiare për vitin 2022, në vlerën totale **1,409,268** (njëmiljon e katërqind e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) në **mijë lekë**, sipas **tabelës Nr.2**, bashkëngjitur këtij vendimi.
- c) Tavanet e shpenzimeve sipas programeve për vitin 2022, në vlerën totale **1,409,268** (njëmiljon e katërqind e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) në **mijë lekë**, sipas **tabelës Nr.3**, bashkëngjitur këtij vendimi.
- d) Planin e investimeve kapitale për vitin 2022, në vlerën totale **97,144** (nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzet e katër) në **mijë lekë**, sipas **tabelës Nr.4**, bashkëngjitur këtij vendimi.
- e) Numri i punonjësve, struktura dhe niveli i pagave për vitin 2022, sipas **tabelës Nr.5**, bashkëngjitur këtij vendimi.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

P R E F E K T I
Zenel Kuçana

